

KRYEARTIKULL

Më shumë të drejta dhe liri për bashkitë e vendit



EDITORIAL

Transformimi i qyteteve përmes komunikimit me qytetarët

Erion Veliaj
President i Shoqatës për Autonomi Vendore



Të dashur miq,
Jam shumë i lumtur që sot Shoqata për Autonomi Vendore publikon numrin e parë të buletinit të saj. Është një projekt ide e cila ka lindur disa kohë më parë dhe që sot më në fund konkretizohet me këtë botim që do të shërbejë si një platformë informimi dhe komunikimi për çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen vendore, me demokracinë lokale, me komunitetet tona. Bashkë me kolegët kemi ndarë gjithmonë besimin se transformimi i qyteteve tona mund të ndodhë vetëm nëqoftëse ne të gjithë arrijmë të krijojmë sinergji me qytetarët duke i parë ata si aksionerë të ndryshimit që duam të sjellim e duke u investuar pa u lodhur për t'i informuar, konsultuar e përfshirë ata në çdo hap të punës tonë. Është kjo e vetmja mënyrë sesi mund të ndërtojmë qytete funksionale, më të mira, më të jetueshme.

VIJON NE FAGEN 2

FORUMI LOKAL

Një hapësirë mendimi publik për të gjithë

“Forumi Lokal” është rubrika e cila do të trajtojë analiza, komente, intervista dhe opinione ardhur drejtpërdrejt nga drejtues dhe punonjës të njëjësive administrative nga i gjithë vendi... 6

OBJEKTIVAT 2018

Drejt progresit për një zhvillim të qëndrueshëm në komunitetet lokale

Objektivat e Shoqatës për Autonomi Vendore për vitin 2018 janë ambicioze, sikurse dhe vizioni i saj për një progres të vazhdueshëm në hapësirat dhe lokalitetet e vendit.... 9



Përmbajtja

DHJETOR 2017 NUMRI 1



01. EDITORIAL

Transformimi i qyteteve përmes komunikimit me qytetarët

03. KUSH JEMI

“Bashkë për bashki të forta”
Znj. Adelina Farrici

04. ARRITJE 2017

Puna e SHAV në vitin që po lëmë pas dhe Sferat Kryesore

06. FORUMI LOKAL

Flasin Emiriana Sako, Bashkia e Durrësit Enkelejda Peshkëpia, Bashkia e Fierit Rezarta Sinanaj, Bashkia e Malësisë së Madhe dhe Gentian Stratoberdha nga Bashkia e Himarës

08. WEBSITE I RI

Regjistrohu për të rejat më të fundit

09. OBJEKTIVAT 2018

Drejt progresit për një zhvillim të qendrueshëm në komunitetet lokale

10. RRJETI

Anëtarët dhe Partnerët



**SHQATA
PËR AUTONOMINË
VENDORE**

Adresa

Bulevardi Zogu I,
Godina 7-katëshe, Kati 5

Email: alisa.limaj@shav.al

Transformimi i qyteteve përmes komunikimit me qytetarët



VIJON NGA FAGE 1

Në këtë kuptim, edhe ky buletin i shtohet një arsenal i gjithnjë e më të pasur mjeteve të praktikash komunikimi, që përfshin zgjidhjet e shumta që na ofron sot teknologjia e informacionit por edhe mënyra më tradicionale, por padyshim po aq të rëndësishme, siç janë dëgjuesat apo konsultimet me komunitetin për vendimmarrjet e rëndësishme, për buxhetin, për projektet strategjike apo për vizionin për transformimin e qyteteve tona.

Rëndësia e këtij botimi bëhet edhe më e kuptueshme, nëse kemi parasysh ndryshimet e mëdha që ka pësuar qeverisja vendore gjatë dy viteve të fundit. Si pasojë e reformës territoriale dhe asaj të decentralizimit ka ndryshuar jo vetëm harta e njësive të qeverisjes vendore, por mbi të gjitha edhe kompetencat e gama e shërbimeve që këto njësi u ofrojnë sot qytetarëve. Nga 13 kompetenca që kishin dikur bashkitë, sot numri ka shkuar në 30, duke përfshirë përgjegjësi të shërbimeve që prekin arsimin, shërbimin shëndetësor parësor, mjedisin, bujqësinë, sipërmarrjen, turizmin e deri sigurinë civile. Transferimi i këtyre kompetencave nga qeverisja qendrore tek ajo vendore jo vetëm i sjell ato më afër qytetarit, por prodhon natyrisht edhe një sfidë të madhe komunikimi në njësitë që mbulojnë sot territore të popullsi shumë herë më të mëdha.

Gjatë dy vjetëve të fundit, Shoqata për Autonomi Vendore ka qenë në pararojë të transformimit të komunikimit me qytetarët dhe të krijimit të një modeli të ri qeverisjeje në partneritet me komunitetin dhe grupet e ndryshme të interesit. Unë jam krenar, që së bashku ia kemi dalë të krijojmë disa standarde të reja të bashkëqeverisjes me qytetarin duke kthyer në praktikë pune disa ide që deri dje ekzistonin thjesht në letër, siç janë buxhetimi me pjesëmarrje apo portalet e aksesueshme e transparente ku qytetarët mund të marrin informacion për çdo aspekt të punës së bashkive. Në zemër të këtij modeli të ri është një parim shumë i thjeshtë: komunikimi është një rrugë me dy korsi. Me pak fjalë, ne nuk duam që qytetarët e grupet e interesit të kthehen në subjekte pasive të fushatave të informimit nga bashkitë, përkundrazi, duam që ata të kontribuojnë në mënyrë të qenësishme me idetë dhe propozimet e tyre. Çka mund ta bëjnë që sot e tutje edhe duke na dërguar për publikim në këtë buletin shkrimet, komentet, analizat, sugjerimet apo rekomandimet e tyre për çdo gjë që ka të bëjë me mënyrën sesi qeverisen sot qytetet tona.

Duke uruar gjithsecilin prej jush për Festat e Fundvitit ju dëshiroj një lexim të këndshëm të këtij buletini.

Juaji sinqerisht,
Erion Veliaj

BASHKË PËR BASHKI TË FORTA

MISIONI

Shoqata për Autonomi Vendore u themelua në 12 Janar 2010, si një bashkim vullnetar dhe i pavarur i Bashkive të Republikës së Shqipërisë, me misionin për më shumë autonomi përmes forcimit e zhvillimit të strukturave dhe mekanizmave demokratike në organizimin dhe funksionimin e Njësive vendore. Vizioni i SHAV mbetet forcimi i të drejtave dhe lirive të këtyre Njësive si një parakusht për zgjidhjen e problemeve të komuniteteve lokale, duke qënë më pranë tyre përmes gjithëpërfshirjes dhe kompetencave në vendimmarrje.



Zj. Adelina Farrici
Drejtoreshë Ekzekutive
prej Janarit 2016

Të dashur lexues,

Në emër të Shoqatës kam kënaqësinë që përmes këtij buletini të ri të mund t'ju përcjellim zhvillimet më të fundit në sferën e pushtetit vendor e veçanërisht duke trajtuar tematika rreth autonomisë vendore dhe sfidave në qeverisjen lokale. Qëllimi i këtij buletini periodik është t'i shërbej njohjes dhe edukimit të të gjithë aktorëve të pushtetit vendor, përfshirë këtu qytetarët e thjeshtë të çdo komuniteti, në lidhje me të gjitha zhvillimet në këtë fushë. Ky pamflet do të përmbajë një shumëllojshmëri informacionesh të trajtuar në disa rubrika ku njëra prej tyre do të përfshij editoriale nga personalitete shtetërore, shoqëria civile, partner ndërkombëtar e personalitete publike. Do të trajtohen aktivitetet e Shoqatës, anëtarëve tanë dhe risitë më të fundit në këtë drejtim. Në vijim do të zhvillojmë intervista me të gjithë aktorët e administratës lokale përfshirë të gjithë bashkitë e vendit, e ku bashkarisht do të diskutojmë rreth sfidave, reformave, politikave dhe specifikave të tjera lokale e qendrore. Në vijim, për të vazhduar me opinione, histori suksesi, e analiza nga modelet më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Një mori informacioni edukues, informues e kultivues, që do të vihet në funksion të lirisë së vendimmarrjes, zhvillimit të qëndrueshëm, transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes, rritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve, ndërtimit të të ardhmes përmes arsimit, sportit dhe kulturës, dhe mbrojtjes së mjedisit përmes përgjegjësisë për një qytet të pastër, janë në vija të përgjithshme temat thelbësore që ne do të trajtojmë. Ndaj ju ftojme të na lexoni dhe të na përcillni komentet dhe sugjerimet tuaja sesi dita ditës së bashku mund të përmirësohemi.

Duke ju falenderuar, përfitoj nga rasti që në emër të Shoqatës për Autonomi Vendore t'ju përcjellim urimet më të sinqerta për festat e fundvitit. Sot e Mot, GËZUAR!

E juaja,

Adelina Farrici

KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues i cili përbëhet nga 7 anëtarë, siguron përfaqësimin, sipas popullatës, larmisë gjeografike, forcave politike të angazhuara në qeverisjen vendore, si dhe drejton veprimtarinë e shoqatës gjatë periudhës midis dy asamblleve të përgjithshme.

KRYESIA E SHOQATËS

Kryesia e shoqatës drejton Asamblenë e Përgjithshme. Ajo përbëhet nga: Kryetari: Erion Veliaj Nënkryetarët: Majlinda Bufi, Zamira Rami, Muharrem Rama

DREJTORI EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës ka kompetencat për drejtimin e veprimtarisë për zbatimin e detyrave të përditshme të shoqatës, Harton planin e aktiviteteve të shoqatës, raporton në organet e shoqatës për aktivitet e kryera, përgatit e ndjek mbledhjet e Keshillit Drejtues dhe Forumeve.

STAFI EKZEKUTIV

Stafi ekzekutiv drejton vendimet e organeve të shoqatës. Shoqata Për Autonomi Vendore kanë në përbërjen e tyre krijim e forumeve për tematika të ndryshme në lidhje me çështjet kryesore të pushtetit vendor. Forumet e Përhershme mbledhen për të diskutuar dhe sygjieruar zgjidhjen e çështjeve sipas fushave të përcaktuara

Arritje 2017

Misioni i Shoqatës për Autonomi Vendore gjatë kësaj periudhe ka qenë konsolidimi dhe fuqizimi i marrëdhënieve me aktorët kryesorë të pushtetit vendor dhe komunitet lokal në vend

BASHKËPUNIM ME AKTORËT KRYESORË TË PUSHTIT VENDOR

Misioni i Shoqatës për Autonomi Vendore gjatë kësaj periudhe ka qenë konsolidimi dhe fuqizimi i marrëdhënieve me aktorët kryesorë të pushtetit vendor dhe komunitetet lokale në vend. Angazhimi dhe bashkëpunimi me anëtarët e saj, organizatat e shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe profesionistëve të fushës, partnerët ndërkombëtar dhe donatorët e ndryshëm, ka qenë kryefjala e punës së Shoqatës për vitin që lamë pas. Në këtë kuadër, vetëm për vitin 2017, ShAV ka zhvilluar më shumë se 20 aktivitete dhe projekte publike kombëtare dhe ndërkombëtare, tryeza, takime, konferenca, vizita dhe trajnime të ndryshme.

PROJEKTE ME BASHKITË EUROPIANE

Këtë vit një fokus të veçantë ka zenë krijimi i urave të komunikimit mes bashkive vendase dhe atyre me përvojë evropiane. Marrja e përvojave dhe modeleve më të mira evropiane si dhe nxitja e bashkëpunimit përmes nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale dhe tërheqjes së projekteve dhe investimeve të huaja në lokalitetet shqiptare, ka qenë një prej bilanceve të suksesit për punën tonë gjatë vitit 2017. Vlen për tu përmendur vizita në rajonin në Emilia Romagna dhe atë në Landin e Veriut të Rhine-Vesfalisë, të Republikës Federale të Gjermanisë. Në të dyja këto vizita përpos lobimit në nivelet më të larta institucionale siç ishin takimet me komunitetin e biznesit, kryetarë bashkish të këtyre vendeve, anëtarë të parlamentit, ministra dhe kryministra, është bërë e



Me Kryeministrin e Landit të NWR, z. Armin Laschet

mundur që të kthejmë vemendjen e këtyre vendeve drejt bashkive tona. Iniciativa të tilla kanë bashkuar mbi 40 kryebashkiakë të vendit, duke zhvilluar qindra takime, seminare, workshope e konferenca brenda dhe jashtë vendit, të cilat kanë korrur marrëveshje dhe bashkëpunime substanciale për të nesërmen e këtyre bashkive.

KONTRIBUT NË HARTIMIN E LIGJIT PËR FINANCAT VENDORE

Në vijim, është punuar njëherazi dhe në drejtime të tjera, duke përfshirë aktivitete që kanë të bëjnë me fushata ndërgjegjësuese dhe trajnime cilësore si me publikun e



AUTONOMIA VENDORE

Përmes forcimit të autonomisë vendore synohet më shumë të drejta dhe liri për qytetarët brenda një njësie të caktuar vendore. Në këtë aspekt, më shumë mundësi për vetëqeverisje përmes strukturave dhe mekanizmave demokratik të zgjedhur prej tyre, do të thotë më shumë mundësi për zhvillim të qëndrueshëm lokal.



DECENTRALIZIMI

Transferimi i më shumë pushteti nga qeverisja qendrore drejt bashkive të vendit sjell një zvogëlim domethënës në kohën e marrë për vendimmarrjen, reduktimin e kostove administrative dhe plotësimin e nevojave reale të komunitetit.

DEMOKRACIA LOKALE

Gjithëpërfshirja e qytetarëve, sektorit privat dhe organizatave jo qeveritare të komunitetit në proceset vendimmarrëse lokale dhe zotërimi në duart e tyre të mekanizmave të llogaridhënies është një parakusht për një demokraci lokale funksionale.



Sferat Kryesore



Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore

gjerë ashtu edhe me grupet e interesit, duke përfshirë pjesëmarrjen dhe kontributin në hartimin dhe zbatimin e reformës së re territoriale në vend dhe të gjithë procesin shoqëruar të decentralizimit. Për vitin 2017, mund të përmendim kontributin e dhënë nga shoqata në kuadër të hartimit të ligjit të ri për financat publike në vend. Shoqata për Autonomi Vendore në bashkëpunim me grupin e punës së Ministrisë së Financave dhe ekspertët e USAID në Shqipëri kanë organizuar disa takime rajonale për të diskutuar mbi draft-projektligjin për financat e vetëqeverisjes vendore. Në këto takime morën pjesë kryetarët e 61 bashkive të vendit, drejtues të financave dhe specialistë, ekspertë të OJF-ve, dhe përfaqësues të komunitetit. Të gjitha opinionet e dala nga këto tryeza u vendosën në dispozicion MF, Këshillit Konsultativ dhe Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe Të drejtat e Njeriut.

RRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE PËRMES TRAJNIMEVE

Zhvillimi i kapaciteteve përmes trajnimeve dhe "workshop"-eve është një tjetër shtyllë e rëndësishme në programin e organizatës tonë. Krahas trajnimeve të ndryshme në bashkëpunim edhe me partnerë të tjerë, për vitin 2017, vlejné për tu veçuar dy prej tyre. Ndërto është trajnimi për "Hartimin dhe Zbatimin e Projekteve të BE" me pjesëmarrje



Forumi i Danubit për Qeverisjen në Ballkanin Perëndimor

të ekipeve nga administrata lokale, një trajnim që synon zhvillimin e kompetencave krahas modeleve të suksesit në politikbërje dhe menaxhimin e burimeve përmes projekteve evropiane dhe standardeve të përcaktuara. Trajnimi për "Menaxhimin e Pyejeve" gjithashtu ka qenë një tjetër angazhim i ShAV në funksion të zbatimit të ligjit për lejet mjedisore, aspekte të ndryshme të administrimit të mjedisit nga pushteti lokal, një iniciativë me rëndësi në kuadër të mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit të lokalitetit. Në këto trajnime morën pjesë qindra punonjës të bashkive të vendit.

FORCIMI I RRJETIT ME SHOQATAT HOMOLOGE DHE ORGANIZMAT NDËRKOMBËTAR

Paralelisht përmes projekteve dhe bashkëpunimeve është punuar si me organizatat homologe nga shoqëria civile po ashtu edhe me organizmat ndërkombëtar për lehtësimin e procesve dhe forcimin e demokracisë lokale në pushtetin vendor. Përveç të tjerash, është punuar në drejtim të zhvillimit të rrjeteve ndërvetëpërdoruese të komunikimit me shoqatat homologe ndërkombëtare dhe aktorët e tjerë në fushën e pushtetit lokal. Përmes vizitave në konferenca dhe kongrese vjetore është bërë e mundur ndarja e eksperiencave dhe e ideve, nisja e bashkëpunimeve të reja dhe marrja e asistencës teknike, si dhe krijimi i strategjive të përbashkëta për t'ju bërë ballë sfidave të reja të mijëvjeçarit.

RRITJA E KAPACITETEVE

Zhvillimi i kapaciteteve në qeverisjen vendore dhe fuqizimi i administratës lokale është një prej përpjekjeve kryesore në ecurinë e reformës së administratës publike në nivel vendor. Prioriteti i SHAV është mbështetja e administratës lokale, për t'iu përgjigjur pritshmërive dhe nevojave të komunitetit për shërbime publike të specializuara.



EDUKIMI DHE SPORTI

Edukimi dhe sporti janë dy komponente tejet të rëndësishme për zhvillimin e një ekosistemi social-kulturor të qëndrueshëm për çdo komunitet në vend. SHAV ka si mision që përmes nxitjes së bashkëpunimit shkollë-komunitet-familje në proceset promovuese dhe zhvilluese të formimit personal të të rinjve në njësinë vendore të përfshijë ata vetë në vendimmarrjet që kanë të bëjnë me të ardhmen e tyre personale.



MJEDISI

Bashkëpunim mes të gjithë aktorëve të njësisë vendore për mbrojtjen dhe pasurimin e mjedisit të lokalitetit është një domosdoshmëri për ruajtjen dhe zhvillimin e ambientit ku këto komunitete punojnë dhe jetojnë.



“Forumi Lokal” është rubrika e cila do të trajtojë analiza, komente, intervista dhe opinione ardhur drejtpërdrejt nga drejtues dhe punonjës të njësive administrative nga i gjithë vendi. Kjo rubrikë synon të mbulojë një sërë tematikash me rëndësi për jetën dhe aktualitetin në komunitetet lokale në mbarë Shqipërinë. Në numrin e parë, përmes një interviste të shkurtër me katër personazhe nga bashki të ndryshme të vendit, vijnë për lexuesin katër tema që lidhen drejtpërdrejt me procesin e reformës territoriale dhe të decentralizimit.

1



TEMA: REFORMA TERRITORIALE BASHKIA DURRES

Emiriana Sako,
Drejtoreshë e Shërbimeve Publike

SA I DOMOSDOSHËM KA QËNË PROCESI I DECENTRALIZIMIT NË FUNKSION TË ZBATUESHMËRISË SË REFORMËS TERRITORIALE DHE SPECIFIKISHT NË BASHKINË E DURRESIT?

Decentralizimi dhe reforma territoriale janë matrica të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Në bashkinë e Durrësit, rezultati i procesit të decentralizimit ka qënë miks, në disa raste kemi patur pjesëmarrje më të madhe në proceset zhvilluese, administratë me efektive në programet e zhvillimit urban e rural, si dhe në raste të tjera janë hasur pengesa ose sfida të vështira në implementimin e funksioneve të reja. Ndër programet më të suksesshme që mund të rendisim në bashkinë tonë, janë ato për implementimin e projekteve të vogla, duke qënë se ka qënë më e lehtë për t'u ndjekur rast pas rasti në mënyrë konstante. Kanë patur kohën e mjaftueshme për tu zhvilluar, si dhe kanë qënë të përqëndruar financiarisht me mbështetje logjistike apo programe trajnuese. Një rast për tu veçuar është ai i kanaleve të II-ta dhe të III-ta të cilat ishin dhe mbeten ende një sfidë e madhe e bashkisë, pasi ato luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e mirëfunksionimit të proceseve agro-turistike në zonat rurale, kanë rol kyç në emergjencat civile, si dhe ndikojnë në një ekonomi të qëndrueshme të vetë zonave. Përpara kësaj reforme, kanë kaluar 20-25 vjet që ky funksion nuk merrte shërbim, si dhe ka patur abuzime me ndërtime pa leje mbi to, mbyllje, devijime e deri ngushtime. Ndaj sfida e Bashkisë Durrës, në lidhje me këtë funksion mbetet ende shumë e madhe, duke patur parasysh edhe risikun e madh që ka Durrësi, për nga pozicioni gjeografik, sa i takon emergjencave civile. Politikat e decentralizimit duhet të dizajnohen dhe organizohen sipas nevojave të lokalitetit, të cilat duhet të jenë të pavarura, por të survejuar nga qendra, në nivel legjislativ dhe gjeografik. Sfida e decentralizimit dhe e reformës, mbetet ngritja e kapaciteteve lokale, dhe pranimi e çuarja përpara e funksioneve e përgjegjësi të reja në menyrë efektive. Mbikëqyrja e këtij procesi nga pushteti qendror është i domosdoshëm, pasi vetë qeveria duhet të luajë një rol kyç në thjeshtimin e procedurave burokratike sikurse dhe në rritjen e mbështjës ndaj nevojave specifike të lokalitetit.



2



TEMA: FINANCAT PUBLIKE BASHKIA FIER

Enkelejda Peshkëpia
Zëvendëskryetare

SA MENDONI SE DECENTRALIZIMI DHE LIGJI I RI PËR FINANCAT VENDORE KANË NDIKUAR NË FUQIZIMIN E PUSHTETIT FINANCIAR LOKAL? ÇFARË PRODUKTI

KONKRET KA DHËNË KY PROCES PËR BASHKINË E FIERIT?

Parimi i decentralizimit të pushtetit është parim thelbësor mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore. Reforma Administrative Territoriale nuk do të kishte të njëjtin kuptim pa decentralizimin dhe njëkohësisht pa miratimin e një Ligji të vecantë për Financat e Vetëqeverisjes Vendore. Megjithatë gjatë procesit të miratimit të këtij Ligji pati di-

FORUMI LOKAL

3



TEMA: ARSIMI BASHKIA E MALËSISË SË MADHE

Rezarta Sinanaj
Shefe e Burimeve Njerëzore

A KA NDIKUAR PROCESI I DECENTRALIZIMIT NË ADRESIMIN MË TË MIRË TË NEVOJAVE LOKALE NË FUSHËN E ARSIMIT NË LOKALITETIN TUAJ? SA KA NDIKUAR KY PROCES NË PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMIT ARSIMOR NË BASHKINË E MALESISE SË MADHE?

Procesi i decentralizimit në arsim përqendrohet në ndarjen e përgjegjësiwe funksionale në sektorin e arsimit ndërmjet niveleve të qeverisjes. Procesi i decentralizimit ashtu siç synohet ka arritur të sjellë procesin vendimmarrës më pranë komunitetit duke i bërë ata që të jenë më të motivuar për të marrë pjesë në procesin qeverisës dhe sigurisht duke mundësuar dhe pjesëmarrje shume më të lehtë.

Nëpunësit e qeverisjes vendore janë shumë më të ndërgjegjshëm përkundrejt nevojave të veçanta, duke qënë se janë më pranë komunitetit. Gjithashtu me një qeverisje vendore së ciles i janë besuar më shumë funksione, procedurat burokratike për komunitetin janë lehtësuar ndjeshëm sepse shumë shërbime merren më shpejt dhe janë më afër.

Ky proces ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e shërbimit arsimor në Bashkinë Malësi e Madhe duke çuar në një menaxhim më të mirë të fondeve publike si rezultat i të cilës për vetëm pak kohë kemi një numër shkollash të rikonstruara shumë më të madh se sa kemi pasur në vite duke krijuar kushte më të mira mesimi për rreth 3 872 nxënës.

4



TEMA: TURIZMI BASHKIA HIMARË

Gentian Stratoberdha
DPZHT

A KA NDIKUAR REFORMA TERRITORIALE NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT TURISTIK NË BASHKINË TUAJ? A KA PATUR ZGJERIM TË GAMËS SË OFERTËS TUAJ TURISTIKE SI PASOJ E KËSAJ REFORME?

Me reformën e re territoria, sot Bashkia Himarë e katërfishuar sipërfaqën e saj juridike çka, paraqet një potencial akoma e më të madh për zhvillime të gjithanshme. Sot Himara është një prej bashkive turistike më të frekuentueshëm në rivierës shqiptare. Pasi iu shtuan dhe dy njësi administrative, Lukova dhe Horë-Vranishti, potenciali turistik rritet dhe më tej duke shtuar gamën ofertuese për turistët e ndryshëm. Sfidat pas kësaj reforme, qëndron në rritjen e efikasitetit të administratës si nga ana profesionale ashtu edhe teknike në mënyrë që të ofrohen shërbime më cilësore për komunitetin dhe jorezidentët turistikë që shumëfishohen nga viti në vit.

Është fakt se reforma e re ka arritur rezultate në rritje në sferën e bashkëpunimit qeverisje vendore me komunitetin dhe cilësinë e shërbimeve turistike ose agro-turistike, përmirësimin e niveleve dhe çuarja në nivele të larta të infrastrukturës sidomos në kuadër të turizmit dhe shërbimeve publike. Një nga qëllimet kryesore të fuqizimit dhe decentralizimit të bashkisë, parashikuar nga ligji i reformës territoriale por dhe nga pushteti vendor, është promovimi i turizmit, produktit vendas, krijimi i markave të tyre dhe rigjenerimi, konservimi, publikimi i siteve që janë pjesë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të kësaj bashkie.

skutime nga shumë faktorë, miratimi i tij ka sjellë risitë e veta dhe ka ndikuar në fuqizimin e pushtetit financiar lokal. Tashmë Bashkia ka të gjitha kopetencat për të shpërndarë vetë dhe pa kufizime të ardhurat nga granti i pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat lokale. Buxhetet dhe ndryshimet e tyre janë më fleksibël. Pavarësisht kalendarit të ngjeshur të parashikuar në këtë Ligj për miratimin e Planeve Buxhetore Vjetore dhe atyre Afat-Mesëm, Bashkia tashmë ka të gjitha mundësitë që të identifikojë dhe të ndryshojë shpërndarjet e fondeve për t'iu përgjigjur në

kohë, me cilësi dhe efikasitet nevojave në rritje të qytetarëve të saj.

Pra zbatimi i këtij Ligji po tenton të realizojë decentralizimin financiar pra zhvendosjen e pushtetit financiar pranë nivelit vendor, me qëllim pajisjen e tij me autoritet më të madh në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Me qëllim realizimin e detyrave nga organet e qeverisjes vendore, realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Website i ri

I pasuruar me përmbajtje substanciale dhe rubrika të reja novatore

Na vizitoni në www.shav.al




Të rejat më të fundit dhe nga celulari juaj?

Për t'u informuar në kohë reale

REGJISTROHU



**SHOQATA
PËR AUTONOMINË
VENDORE**



OBJEKTIVAT PËR 2018

"Drejt progresit për një zhvillim të qëndrueshëm në komunitetet lokale"

1



Bashkëpunim me universitetet, median, partnerët nga shoqëria civile, opinionbërësit, organizatat e biznesit, dhe komunitetet fetare me qëllim hartimin e planeve dhe aktiviteteve strategjike sipas grupeve specifike.



2

Zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere me komunitetet lokale kryesisht në zonat rurale dhe të izoluar.



3

Prezantojmë programin për rritjen e transparencës në bashki, përmes lehtësimit të përfshirjes së komuniteteve në proceset demokratike e social-kulturore, shkollës së hapur për komunitetin dhe nxitjes së vullnetarizmit në mbrotje të mjedisit.



4

Rrisim bashkëpunimin me specialistët ndërkombëtarë dhe donatorët e huaj me synim ofrimin e trajnimeve cilësore dhe të asistencës teknike për burimet njerëzore, dhe mënyrës së komunikimit me qytetarët në institucionet e qeverisjes vendore.

5

Do të shpreshtojmë vizitat dhe takimet rajonale e ndërkombëtare me zyrtarë të lartë shtetëror e lokal, si dhe me organizatat homologe në vendet fqinje e më tej.



6

Organizojmë "Konferencën Ballkanike për Pushtetin Vendor" në Durrës me shoqatat homologe, organizatat nga shoqëria civile si dhe me përfaqësues të lartë të pushtetit qendror e lokal nga vendi e rajoni.



7

Hapim shkollën Verore për Qeverisjen Vendore.

8

Krijojmë njësinë për hulumtin, shkrimin, monitorimin e standardeve, e të modeleve më të mira europiane dhe tërheqjen e projekteve ndërkombëtare.



9

Do të llobojmë dhe bashkëpunojmë ngushtë me institucionet qendrore, siç është zyra e Zëvendëskryeministrit, Ministria e Punëve të Brendshme, apo Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara - ADISA, me qëllim rritjen e cilësisë dhe modernizimin e ofrit të shërbimeve publike në nivel qeverisje vendore bazuar në standardet evropiane.



10

Përmes ekspertizës sonë vazhdojmë kontributin në propozimin e amendimeve ligjore në funksion të plotësimit të standardeve dhe realizimit të misionit të pushtetit vendor në vend.

ANËTARËT



Bashkia Belsh



Bashkia Berat



Bashkia Bulqizë



Bashkia Cërrik



Bashkia Delvine



Bashkia Divjakë



Bashkia Durrës



Bashkia Elbasan



Bashkia Fier



Bashkia Finiq



Bashkia Fushë Arrëz



Bashkia Gjirokastrë



Bashkia Gramsh



Bashkia Has



Bashkia Himarë



Bashkia Kavajë



Bashkia Këlcyrë



Bashkia Kolonjë



Bashkia Konispol



Bashkia Korçë



Bashkia Krujë



Bashkia Kuçovë



Bashkia Kurbin



Bashkia Libohovë



Bashkia Librazhd



Bashkia Lushnjë



Bashkia Malësi Madhe



Bashkia Maliq



Bashkia Memaliaj



Bashkia Mirditë



Bashkia Patos



Bashkia Peqin



Bashkia Peshkopi



Bashkia Polican



Bashkia Prrerjas



Bashkia Pukë



Bashkia Pustec



Bashkia Roskovec



Bashkia Rogozhinë



Bashkia Sarandë



Bashkia Shijak



Bashkia Skrapar



Bashkia Tepelenë



Bashkia Tiranë



Bashkia Ura Vajgurore



Bashkia Vlorë

PARTNERËT

Shoqata për Autonomi Vendore, ka për qëllim të llojë e të jetë një zë i fuqishëm në bazë të politikave e të vizionit të cilat janë paraqitur në statutë, për të mbrojtur e monitoruar interesat e anëtarësisë. Ndaj për ne partneriteti dhe bashkëpunimi me shoqatat homologe ndërkombëtare në përfitim të eksperiencave më të mira europiane dhe rajonale është një domosdoshmëri. Sot Shoqata operon në partneritet të ngushtë me rrjetet më të rëndësishme të shoqatave lokale Europiane dhe JugLindore dhe është një anëtare me të drejta të plota në European Association for Local Democracy.



UNITED NATIONS



UNDP



EU COMMISSION



EU DELEGATION



USAID



US EMBASSY IN TIRANA



SWISS COOPERATION



GIZ



HANS SEIDEL FOUNDATION



FRIEDRICH EBERT STIFTUNG FOUNDATION



OPEN SOCIETY FOUNDATION



OSCE



GOVERNMENT OF ALBANIA



PARLIAMENT OF ALBANIA



NALAS



CCER



EUROPEAN ASSOCIATION OF LOCAL DEMOCRACY



EMILIA ROMANA



CNVP



AUSTRIAN DEVELOPMENT COOPERATION



FOUNDATION FOR LOCAL AUTONOMY AND GOVERNANCE



KfZ



WORLD VISION



FEDERATA KOMBËTARE E PYJEVE DHE KULLOTAVE KOMUNALE



VNG INTERNATIONAL



DECENTRALIZATION AND LOCAL DEVELOPMENT PROGRAMME



THE WORLD BANK

Së bashku ndërtojmë
të ardhmen e komunitetit tonë!



**SHOQATA
PËR AUTONOMINË
VENDORE**